



	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	
---	---	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05-391/02-121430/24 dt.16.09.2024, të kërkuësve/bashkëpronarëve, Lumnije Jashari, Nazmije Gashi, Sanije Islami, Mevlude Potera, Ismail Poteri Albing Bshpk, Shqipe Gashi-Poteri, Alban Ramadani, Naim Shkelzen dhe Xhelal Sopi, Ismet Bullatovci, Besim dhe Bardhyl Sopi, Hanife Mema, dhe Sadik Bucolli nga Prishtina dhe Investitori Albing Be shpk me përfaqësues Sejfidin Hasani nga fshati Brezne Komuna e Prizrenit për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “1”, Ndërtesa “2”, Ndërtesa “3”, dhe Ndërtesa garazhuese, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “b-17”, të nën tërsisë “B-4”, të tërsisë “B”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët”, në Prishtinë, në rr. “Isa Kastrati”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë të rregullt administrative, me datë 10.10.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuësve / bashkëpronarëve, Lumnije Jashari, Nazmije Gashi, Sanije Islami, Mevlude Potera, Ismail Poteri Albing Bshpk, Shqipe Gashi-Poteri, Alban Ramadani, Naim Shkelzen dhe Xhelal Sopi, Ismet Bullatovci, Besim dhe Bardhyl Sopi, Hanife Mema, dhe Sadik Bucolli nga Prishtina dhe Investitori Albing Be shpk me përfaqësues Sejfidin Hasani nga fshati Brezne Komuna e Prizreni, sipas kërkesës 05-391/02-121430/24 dt.16.09.2024, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “1” me etazhitet 2B+2S+P+14, Ndërtesa “2” me etazhitet -B+2S+P+14, Ndërtesa “3” me etazhitet -2B+S+P+14 dhe Ndërtesa garazhuese me etazhitet -3B, të ndërtuara sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit”, 05 Nr.351/02-35585/20 dt.21.07.2020, lëshuar kjo drejtori, në parcelën kadastrale nr. 10313-0, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urban “b-17”, të nën tërsisë “B-4”, të tërsisë “B”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët”, në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Isa Kastrati” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: Nr. 51, 51/1, 51/2, 51/3, 51/4, 51/5, 51/6, 53, 53/1, 53/2, 53/3, 53/4, 55, 55/1, 55/2, 55/3, 55/4, 57, 57/1, 57/2, 57/3, 57/4, 57/5, 59, 59/1, 59/2, 59/3, 59/4, 59/5, 61, 61/1, 61/2, 61/3, 61/4, 61/5, 61/6, 61/7, 61/8, 61/9, 61/10, 61/11, 63, 63/1 dhe 63/2, në rruga në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoren dhe lshfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësisve të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Arsyetim

Kërkuesit / bashkëpronarët, Lumnije Jashari, Nazmije Gashi, Sanije Islami, Mevlude Potera, Ismail Poteri Albing Bshpk, Shqipe Gashi-Poteri, Alban Ramadani, Naim Shkelzen dhe Xhelal Sopi, Ismet Bullatovci, Besim dhe Bardhyl Sopi, Hanife Mema, dhe Sadik Bucolli nga Prishtina dhe Investitori Albing Be shpk me përfaqësues Sejfidin Hasani nga fshati Brezne Komuna e Prizreni, me kërkesën 05-391/02-121430/24 dt.16.09.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin me ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa "1" me etazhitet 2B+2S+P+14, Ndërtesa "2" me etazhitet -B+2S+P+14, Ndërtesa "3" me etazhitet -2B+S+P+14 dhe Ndërtesa garazhuese me etazhitet -3B, të ndërtuar në kuadër të bllokut urban "b_17", të nën tërsisë "B-4", të tërsisë "B", të Planit Rregullues "Muhaxhirët, ne Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10313-0, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas "Vendimit për Lejimin e Ndërtimit", 05-Nr.351/02-35585/20 dt.21.07.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09-391/60537/24 dt. 06.09.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspeksionit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, Nexhat Bytyqi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Sejfidin Hasani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Qamil Shala; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Petrit Hajrizi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Dorela Beqiraj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve për mbrojtje nga zjarri, nga mbikqyrësi Naser Temaj; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Faton Bajselmani me nr. të licensës 125;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspeksionit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumëbanesore me afarizëm si dhe ndërtesa garazhuese mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që kompleksi me ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, dhe ndërtesa



garazhuese mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për kompleksin me ndërtesat shumëbanesore me afarizëm dhe ndërtesa garazhuese.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 NR. 391/02-121430/24 DT. 10.10.2024



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

Zyrtarja,

Bahtije Vllasaliu

